

NË DEMOKRACI

Demokracia është si një lule, nëse e ujitim ajo rritet.



NE E BËJMË NDRYSHIMIN

DEMOKRACIA SIPAS FËMIJËVE

ARGJEND (9), EDONISA (8), KALTRINA (8), VENESA (8), ANEA (8), YLLI K. (8), DONART (8)

Ne jemi klasa III-1, nga shkolla „Nazim Gafurri“ nga qyteti i Prishtinës. Sot ne kemi qenë gazetarë të demokracisë dhe kemi mësuar shumë gjëra për demokracinë. Ato do t'i tregojmë në artikullin tonë


Ne mësuam për demokracinë. „Demos“ do të thotë popull, ndërsa fjala „kratia“ do të thotë fuqi, udhëheqje ose pushtet. Këto fjalë rrjedhin nga gjuha greke, sepse aty ka lindur demokracia. Që nga viti 507 para erës sonë, ne kemi demokraci. Në fillim kemi pasur demokracinë e drejtpërdrejtë, kurse më vonë demokracinë përfaqësuese. Në Kosovë kemi demokracinë përfaqësuese që nga 17 shkurti 2008. Ne si fëmijë të lindur në Kosovën demokratike, kemi disa të drejta dhe përgjegjësi. Ne kemi të drejtë të shkollohemi, por kemi përgjegjësi t'i bëjmë detyrat. Ne kemi të drejtë të kemi një familje, por të gjithë ne duhet të respektojmë njëri-tjetrin. Porosia jonë është të bashkohemi të gjithë për demokracinë e vendit tonë.



Shkrimet tona mbi demokracinë




Ne i respektojmë të gjithë



Lulet tona të demokracisë




Në fotografi me të gjithë grupin duke punuar



Pema e mbushur me të drejtat tona



Prejardhja e fjalës demokraci



Funksionet e Kuvendit të Kosovës



Duke e kryer detyrën e grupit „Shega“




Përfaqësuesit e Kuvendit të Kosovës



Ne kemi të drejtë të kemi shoqëri

KUVENDI DHE DEPUTETËT E RINJË

BLERIM (8), ELSARA (8), ERINA (8), OLSA (8), LEON (8), RREZON (8), YLL (8)




#ÇKA ËSHTË KUVENDI I KOSOVËS

Kuvendin e Kosovës ne si fëmijë e njohim si „Shtëpia e Popullit“ sepse përfaqësuesit (deputetët) janë të zgjedhur nga qytetarët. Këta përfaqësues kanë për detyrë ta përfaqësojnë popullin në mënyrën më të mirë të mundshme. Këta përfaqësues gjatë kohës sa janë në Kuvend, mundohen që çdo detyrë të tyre, ta përfundojnë sa më mirë që është e mundur.

Kuvendi i Kosovës ka gjithësej 120 deputetë të cilët së pari janë qytetarë të mirë, të ndershëm, të dëgjueshem, etj. Po kush ka të drejtë të kandidoj për deputet? Të kandidoj për deputet ka të drejtë secili qytetarë i Kosovës i cili është mbi moshën 18 vjeçare. Kuvendin

FUNKSIONET E KUVENDIT TË KOSOVËS

di i Kosovës ka shumë detyra dhe funksione por ne do t'iu informojmë më shumë rreth tri funksioneve kryesore që Kuvendi ka. Me funksionin legjislativ kuptojmë që Kuvendi përpos që mund të propozoj ligje po ashtu mund të miratojë dhe të mos miratojë ligjet të cilat mund t'i propozoj Qeveria. Detyrë tjetër e Kuvendit është ta mbikëqyrë Qeverinë. Kjo sepse ligjet që i ka miratuar Kuvendi, Qeveria duhet t'i zbatoj. Si dhe funksioni i tretë i Kuvendit është përfaqësimi i popullit, që do të thotë që deputetët duhet ta përfaqësojnë popullin. Nga gjithë kjo që u tha më lartë, ne nxënësit e grupit „Rrushi“ këtu e përmbyllim artikullin.



Një pemë me disa funksione të Kuvendit



Puna e grupit „Rrushi“

TË BARABARTË NË TË DREJTA DHE PËRGJEGJËSI

ARJANI (9), ENGJULLI (9), ANILA (7), ESMA (8), MELIKU (8), DUERTA (8), FLOGERTA (8)

Ne sot kemi folur se si duhet të jemi qytetarë të mirë, duke i kryer përgjegjësitë tona dhe duke i shijuar të drejtat tona. Për më shumë, lexoni artikullin më poshtë

Jeta është e bukur kur ne jetojmë në një vend demokratik siç është Kosova. Por që ta kemi jetën më të mirë, demokracia na ofron të drejta pa dallime feje, race, gjinie, kombësie, moshe etj. Disa nga këto të drejta janë: e drejta për tu argëtuar, e drejta për tu shkolluar, e drejta e strehimit, e drejta të ushqehemi, e drejta për të krijuar familje (kur ti mbushim 18 vjet), e drejta të vishemi, e drejta për të jetuar, e drejta të kemi një emër etj. Ne gjithashtu duhet t'i përmbushim përgjegjësitë tona e ato janë: të lexojmë, të mësojmë, të ndihmojmë, ti bëjmë detyrat, ti respektojmë të tjerët, të kujdesemi për veten, ta mbajmë premtimin, ti dëgjojmë prindërit, të kujdesemi për pronat e shtetit, etj.




Grupi "Dredhëza,, të përkushtuar në punë



Ta respektojmë komunikacionin



Disa nga të drejtat e qytetarëve punuar nga Meliku



Disa nga përgjegjësitë e qytetarëve, punuar nga Engjulli



Ta mbajmë ambientin pastër



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Nazim Gafurri“
Klasa: VII-1
Vendi: Mirash, Ferizaj